



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:177183

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05746280

KA.nr.470/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Lake Side” ShPK me NUI 811284603 dhe seli në Vermicë të Prizrenit, i cili përfaqësohet sipas prokurës nga avokati Sylë Hoxha me seli në rrugën Ibrahim Rugova p.nr. në Prizren, kundër të paditurit 1) Inspektorati Sanitar i Kosovës, dhe 2) Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 30.04.2024 në të cilën mori pjesë përfaqësuesi i paditësit, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, më 13 maj 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “LakeSide” ShPK me NUI 811284603, anulohet në tërësi vendimi AUV.nr.04/2-2296/2020 i datës 24.11.2020 i të paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe çështja administrative vendoset si në vijim:
 - 1) Aprovohet ankesa e Lake Side” ShPK me NUI 811284603 dhe seli në Vermicë të Prizrenit dhe anulohet fletëpërmbajtja për kundërvajtje me numër serik 004302/IS e datës 01.11.2020 e Inspektoratit Sanitar të Kosovës në Komunën e Prizrenit.
- II. Hedhet poshtë padia e paditësit “LakeSide” ShPK me NUI 811284603 në pjesën me të cilën ka kërkuar anulimin e procesverbalit mbi inspektimin e bërë të datës 01.11.2020 me numër serik 000867 të Inspektoratit Sanitar të Kosovës në Komunën e Prizrenit.
- III. Ky aktgjykim e zëvendëson aktin administrativ të anuluar si në pikën I. të këtij dispozitivi.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Padiësi përmes padisë së datës 15.12.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e procesverbalit numër 000867 të datës 01.11.2020 të së paditurit Inspektorati Sanitar të Kosovës dhe vendimi AUV Ref.04/2-2296/2020 të datës 24.11.2020 të së paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.
2. Ai në padi por edhe gjatë seancës për shqyrtimin e kryesore të çështjes, si dhe në fjalën përfundimtare ka pretenduar se më datë 01.11.2020 në orën 17:30 minuta Inspektorati Sanitar gjatë kontrollit kanë hasur në mysafirë, të cilët kanë qenë duke darkur secili në tavolina të shpërndara dhe në një distancë të duhur sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe vendimeve të qeverisë së Republikës së Kosovës. Sipas tij, ata mysafirë kanë qenë të rastit dhe nuk ka qenë i organizuar asnjë aheng familjar siç pretendojnë inspektorët në procesverbalin e përpiluar me nr. 000867, gjë e cila vërtetohet me shqimin e kamerave të sigurisë. Më tutje ka theksuar se është e vërtetë së në kompleksin hotelier “LakeSide AG” është një sallë për organizimin e ahengjeve dhe dasmave, por ajo në ditën kritike ka qenë e zbrazët sepse ishte e pa përfunduar dhe nuk ishte në shfrytëzim, por i ka pasur vetëm dritat e ndezura duke shërbyer për ndriçimin e parkingut. Ka deklaruar se Inspektorat Sanitar në pikën 2 të procesverbalit kanë deklaruar se në momentin e inspektimit është hasur në personel dasmor të cilën në mënyrë të organizuar dhe me lejen e subjektit ka bërë organizimin e ahengut, duke mos vërtetuar gjendjen faktike të saktë në vendin e ngjarjes.
3. I padituri në përgjigje e tij në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Padiësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë si të pabazuar. Ai ka deklaruar se pretendimet e Padiësit janë të pa bazuara dhe të paqëndrueshme sepse Inspektorati Sanitar i AUV-së në bashkëpunim me Policinë e Kosovës më datë 01.11.2020 në ora 17:30 ka gjobitur në shumë prej 2000€ Padiësin për arsye se ai nuk i ka respektuar masat Anti-Covid-19, të përcaktuara me vendimin e qeverisë të datës 25.09.2020 me nr. 01/32 pika 7, me të cilin është përcaktuar se janë të ndaluara të gjitha tubimet publike përfshirë edhe ahengjet familjare, në kundërshtim me Ligjin Nr. 07/1-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19, pasi Padiësi ka organizuar aheng familjar.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

4. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi nr. AUV.ref.04/2-2296/2020 i datës 24.11.2020 me numër të protokollit 7071 të datës 26.11.2020, i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; ankesa e Paditësit kundër fletëparaqitjes për kundërvajtje 004302/IS të datës 01.11.2020; procesverbali mbi inspektimin e bërë me numër serik 000867 i datës 01.11.2020 i AUV në emër të Paditësit; fletëpërmbajtja për kundërvajtje me numër 004302/IS e datës 01.11.2020 në emër të Paditësit, parashtrësja e të paditurit AUV për deklaram rreth seancës, të gjitha shkresat e lëndës në procedurën administrative, si dhe u shikuan materialet video me titull AFGS1308, BRIH3835, GEPI7466, IMG_3856, IMG_3857, IMG_3858, IMG_3859 dhe IMG_3860 nga CD-ja.
5. Gjkata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
6. Inspektorati Sanitar i Kosovës në komunën e Prizrenit në bazë të një njoftimi të mëhershëm më 01.11.2020 rreth orës 17:50 kishte kryer inspektimin të restoranti i Paditësit dhe kishte konstatuar se ka hasur dasmor, të cilët në mënyrë të organizuar dhe me leje të Paditësit kanë organizuar aheng. Me këtë konstatim nuk ishte pajtuar Paditësi. Këtë fakt gjykata e konstatoi përmes procesverbalit mbi inspektimin e bërë me numër serik 000867 të datës 01.11.2020 të Inspektoratit Sanitar të Kosovës.
7. Gjithashtu më 01.11.2020 Inspektorati Sanitar i Kosovës përmes fletëpërmbajtjes për kundërvajtje me numër serik 004302/IS e kishte gjobitur Paditësin me 2000€ për ahengun të cilin e kishte konstatuar në procesverbal. Këtë fakt gjykata e konstatoi përmes fletëpërmbajtjes së sapo cekur.
8. Më 03.11.2020 Paditësi kishte parashtruar ankesë kundër fletëpërmbajtjes së cekur më lartë, ndërsa i padituri Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë përmes Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave më 24.11.2020 kishte dhënë vendimin AUV.Ref. 04/2-2296/2020 e kishte refuzuar ankesën e Paditësit. Këtë fakt gjykata e konstatoi përmes vendimit të sapo cekur.

9. Nga material video gjykata konstatoi se në momentin kur Inspektorati Sanitar i Kosovës kishte kryer inspektimin më 01.11.2020 në orën 17:50, Paditësi nuk kishte organizuar aheng, gjegjësisht dasmë. Në videot e administruara shihet qartë momenti kur inspektorët së bashku me zyrtarët policor kanë hyrë në hapësirat e restorantit të Paditësit, ndërsa salla e dasmave ishte zbrazët, tavolinat ishin të pa dekoruara, si dhe në një pjesë të tyre nuk kishte as karrige. Gjithashtu, nga videot konstatohet se parkingu i restorantit të Paditësit, i cili i kishte vetëm disa automjete. Përveç kësaj, në video shihet restoranti ditur i Paditësit me disa mysafirë, por të cilët nuk kishin veshje dasmorësh e as nuk ishin të shumtë në numër. Nga shkresat tjera të lëndës nuk rrjedh asnjë rrethanë, në bazë të cilave do të mund të vërtetohej se Paditësi kishte organizuar ose po planifikonte organizimin e ndonjë ahengu.
10. Në këtë drejtim gjykata sqaron se ora e gabuar për një orë në videot e shikuara ka ardhur si rezultat i ndërrimit të orës nga sezoni verore në atë dimërore. Është fakt notor që ora ndërrohet gjithëherë të dielën e fundit të muaji mars dhe tetor të vitit përkatëse. Kështu, e diela e fundit e muajit tetor të vitit 2020 ishte data 31.10.2020, pra një ditë para se të ndodhë inspektimi.

III. Vlerësimi meritor i rastit

11. Gjykata në rend të parë e vlerësoi padinë e Paditësit, me të cilën është goditur procesverbali mbi inspektimin e bërë të datës 01.11.2020 me numër serik 000867 dhe gjeti se ajo në këtë pjesë është e palejueshme.
12. Sipas nenit 13 para. 1 të LKA-së “*Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë*”, ndërsa në para. 2 së të njëjtin nen përcaktohet se “*Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar*”. Objektin e konfliktit administrativ e ka rregulluar edhe neni 14 i LKA-së, sipas të cilit “*Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj.*”
13. Siç vërehet nga dispozitat e neneve të cituar më lartë, objekt i shqyrtimit në konfliktin administrativ mund të jetë vetëm shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit administrativ

përfundimtar të organit administrativ të shkallës së dytë ose të shkallës së parë në raste të caktuara, si dhe heshtja administrative.

14. Neni 3 para. 1.2 i LKA-së aktin administrativ e ka definuar se “*Akt administrativ - çdo vendim të organit të paraparë në nën-paragrafin 1.1. të këtij paragrafi, i cili merret në fund të një procedure administrative në ushtrimin e autorizimeve publik edhe që prek, në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjërish, liritë ose interesat e personave fizikë ose juridikë përkatësisht palës tjetër në vendosjen e çështjes administrative*”. Nga ky definicion ligjor vërehet se, për tu konsideruar një veprim procedural administrativ si akt administrativ në kuptim të LKA-së, ai duhet që (i) të nxirret nga një organ administrativ në kuptim të LKA-së, (ii) të nxirret në fund të procedurës administrative në ushtrimin e autorizimeve publik, (iii) që në vendosjen e çështjes administrative t’i prek në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjërish, liritë ose interesat e palëve në procedurën administrative.
15. Në rastin konkret, procesverbali i goditur nuk i plotëson kushtet ligjore të sqaruara më lartë për të qenë akt administrativ në kuptim të LKA-së, rrjedhimisht nuk mund të jetë objekt i konfliktit administrativ. Ai nuk paraqet veprim procedural i ndërmarr në fund të procedurës administrative, por paraqet veprim procedural me të cilin i Padituri si organ administrativ kompetent i bënë konstatimet e tij me rasti e inspektimit.
16. Prandaj, gjykata vlerëson se fletëpërmbajtja e goditur nuk paraqet akt administrativ ndaj të cilit mund të paraqitet padia, rrjedhimisht e hodhi poshtë padinë si në pikën II. të dispozitivit, në bazë të nenit 34 para. 1 nënpara. 1.2 të LKA-së, sipas të cilit “*Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se (...) akti që kontestohet me padi nuk është akt administrativ*”. Në lidhje me këtë gjykata sqaron se edhe pse Paditësi procesverbalit i referohet si vendim, megjithatë ai nuk paraqet vendim por thjeshtë procesverbal në të cilin janë përshkruar veprimet faktike të ndërmarra nga Inspektorati i Sanitar gjatë inspektimit.
17. Lidhur me kërkesëpadinë e Paditësit, me të cilën ka kërkuar anulimin vendimi AUV.nr.04/2-2296/2020 i datës 24.11.2020 i të paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë gjykata gjeti se kërkesëpadija e është e bazuar.
18. Gjykata në rend të parë vlerësoi se i Padituri e ka zbatuar procedurën administrative në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat procedurale të paraparë me ligjet e veçanta, të cekur në këtë aktgjykim. Për më tepër, gjykata vlerëson se vendimi i goditur e ka

formën e aktit administrativ në përputhje me nenin 47 të LPPA-së si dhe arsyetimi i tij i përmban të gjitha informacionet dhe sqarimet e kërkuara me nenin 48 të LPPA-së. Gjykata rikujton se Paditësi nuk kishte ngritur ndonjë pretendim në këtë aspekt.

19. Megjithatë, gjykata gjeti se gjendja faktike nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë. Siç është sqaruar edhe më lartë, në njërën anë në shkresat e lëndës nuk ka prova se Paditësi kishte organizuar ose po organizonte dasmë në hapësirat e restorantit të tij, e në anën tjetër nga materiali video shihet qartë se në momentin kur Inspektorati Sanitar e kishte kryer inspektimin Paditësi nuk kishte qenë duke organizuar dasmë.
20. Si rezultat i konstatimit të gabuar të gjendje faktike, vendimi i goditur është nxjerr edhe në kundërshtim me të drejtën materiale. Sipas nenit 25 para. 1 të Ligjit 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës *“Personi juridik që organizon aktivitete të ndaluara me vendim të Organit Kompetent dënohen me gjobë prej dy mijë (2000) euro dhe ndalimin e aktivitetit, ndërkaq personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë me dymijë (2000) euro”*. Meqenëse nuk është konstatuar se Paditësi ka organizuar dasmë, atëherë dispozita e sapo cituar nuk mund të gjej zbatim.
21. Në anën tjetër, sipas nenit 13 para. 1 të Ligjit 05/L-087 për Kundërvajtje *“Kryesi i kundërvajtjes është personi i cili me veprimin ose mosveprimin e vetë ose përmes personit tjetër kryen kundërvajtje”*. Siç vërehet, kryerës i kundërvajtjes është personi i cili ka ndërmarrë veprimin, në këtë rast personi që ka organizuar dasëm.
22. Prandaj, duke u nisur nga fakti se Paditësi nuk ka organizuar asnjë dasmë në ditën dhe kohën e përshkruar më lartë, atëherë gjykata vjen në përfundimin se Paditësi nuk e ka kryer kundërvajtjen me të cilën është ngarkuar. Rrjedhimisht gjeti se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet dhe karakteri i çështjes e lejon që gjykata të vendos me juridiksion të plotë, si dhe të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, për pasoj me aktgjykim vendosi për çështjen administrative, siç mundëson neni 46 para. 4 i LKA-së. Po ashtu, në bazë të njëjtit paragraf gjykata rikujtoi se ky aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar.
23. Duke u bazuar në nenet 13 para. 1 nën para. 1.12 lidhur me para. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, nenin 46 të LKA-së, nenin 64 Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.470/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.